



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

- f) **“Menaxhim Inteligjent për sigurinë e automjeteve”** në partneritet me: Universiteti Jonian i Korfuzit Bashkia Korfuz, Bashkia Vlorë, me një buxhet total prej **700.000EUR**.
- g) **“Sistem mbikëqyrjeje, kontrolli dhe parandalimi të popullimit të mushkonjave në tre zona ndërkufitare turistike: Vlorë-Korfuz-Thesprotia”**, në partneritet me: Universiteti Jonian të Korfuzit, Ministrinë e Mjedisit, me një buxhet total prej **300.000EUR**.
- h) **“Rrënjët e përbashkëta kulturore dhe artistike përmes bashkëpunimit ndërkufitar kulturor”**, në partneritet me: qendrën “Kulture media art” Tiranë; Bashkinë Korfuz dhe qendrën POLISCulture në Korfuz, me një buxhet total: **700.000EUR**.
- i) **“Zhvillimi turistik dhe kulturor përmes krijimit të ofertave të reja si mekanizëm për zgjatjen e sezonit turistik”**, në partneritet me: Bashkinë Gjirokastrë, Dhomën e Tregtisë Janinë, Zyrën turistike Florinë, Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Vlorë, me një buxhet total: **700.000EUR**.
- j) **“Metodologji inovative për rritjen e të ardhurave, eksportit dhe investimeve të bizneseve të vogla dhe të mesme”**, në partneritet me: Dhomën e Tregtisë Janinë, Bashkinë Dropull dhe Dhomën e Tregtisë Kastoria, me një buxhet total: **700.000EUR**.
- k) **“Kultura e Ullirit: Kontributi në rritjen e sektorit të ullirit, duke promovuar praktikën e mira të kultivimit, duke aplikuar teknologji të sakta bujqësore precision për të krijuar produkte të reja vendore dhe mbështetur bizneset e vogla dhe të mesme”**, në partneritet me: bashkinë e Nikolaos Skoufas (Greqi), Institutin e Edukimit Teknologjik të Epirit, Universitetin Jonian, Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë dhe bashkinë Berat, me një buxhet total **700.000EUR**.
- l) **“Promovimi i potencialeve turistike dhe kulturore me qëllim hapjen e tregut të ri të turistëve kinezë”**, në partneritet të propozuar me: INNOPOLIS Korfuz, Bashkia Korfuz, AUELDA, DRKK Vlorë, me një buxhet total **700.000EUR**.
- m) **“Ndërlidhja e territoreve shqiptare dhe greke përmes transportit publik me qëllim promovimin e koordinuar të potencialeve turistike të të dyja territoreve”**, në partneritet të propozuar me: Institutin e Edukimit Teknologjik të Epirit, bashkinë Sarandë, Bashkinë Finiq, me një buxhet total **700.000EUR**.

2- Vlera e bashkëfinancimit në zbatimin e këtyre projekteve, si kontribut i Këshillit të Qarkut është parashikuar në masën 15%.